



Pranuar / Dorezuar Punëhënë / Proradato Received / Delivery	23.03	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	No. Prot Dr. Prot Prot No	Shtesa e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRIPSHK	1540/22		1/4	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.139/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.139/2022 të datës 16.02.2022, të parashtruar nga ankuesja [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat [redacted]

[redacted] Prishtinë, kundër heshtjes administrative të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 në paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.139/2022 e datës 16.02.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] nëpunësve civile në Agjencinë e Regjistrimit Civil, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim më datë 16.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtje administrative të Thesarit të Kosovës lidhur me kërkesën e ankueses të datës 20.12.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Thesarin e Kosovës. Më datë 02.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Thesari i Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 809/2022 të datës 16.02.2022 të parashtruar nga ankuesja në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 09.02.2022; Vendimin me numër protokoll 03/39 të datës 01.08.2019; Kërkesën për aprovimin e shtesës në pagë të datës 20.12.2021 e parashtruar nga ankesë për Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit; Emailin e datës 11.02.2022 nga ankuesja; Kërkesën për aprovimin e shtesave në pagë të datës 12.11.2019 nga ankuesja për Menaxheren e Personelit të MPB-së; Kërkesën për aprovimin e shtesave në pagë të datës 24.07.2020 nga ankuesja për Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit; Emailin e datës 19.11.2019 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 13.11.2019 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 11.08.2020 nga [redacted] për [redacted] Emailin e datës 02.10.2019 nga [redacted] për ankuesen; Emailin e datës 02.10.2019 nga ankuesja për [redacted] Shkresë për aprovimin e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare e datës 24.04.2009 nga Ministria e Shërbimeve Publike; Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Formularin e të dhënave për listën e pagave i datës 09.09.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.02.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 02.03.2022; Vendimin me Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës së bashku me Aneksin Lista e titujve të punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita; Vendimin e datës 05.11.2018 për emërimin e Komisionit për shqyrtimin e shtesave të fushës së teknologjisë informative dhe inxhineringut; Emailin e datës 16.11.2018 nga [redacted] Vendimin e datës 27.12.2018 nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave shtesa në pagë në fushën e TI.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **paabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja e punësuar në pozitën *Udhëheqës e Sektorit për Verifikimin e të Dhënave*, në bazë të Vendimit me numër protokoll 03/39 të datës 01.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil është emëruar ushtruese e detyrës së Drejtores së Drejtoratit për Prodhimin e Dokumenteve. E njëjta me datë 12.11.2019 i është drejtuar me kërkesë menaxheres së Personelit të MPB-së për aprovimin e shtesave në paga për pozitën menaxher II duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.02/39 të datës 08.10.2008. Me kërkesë të njëjtë ankuesja i është drejtuar edhe Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, dhe atë më datë 24.07.2020 dhe 20.12.2021, mirëpo në bazë të shkresave të lëndës nuk ka marr përgjigje.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për shkak të heshtjes administrative të Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës, lidhur me kërkesën e datës 20.12.2021, pretendon që sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i takon e drejta e kompensimit të shtesës mbi pagën bazë për pozitën Drejtori i Drejtoratit për Prodhimin e Dokumenteve e cila është kategorizuar në Menaxher II më shtesë prej 500 Euro në muaj. Me tej shton se të gjithë drejtoret dhe ushtruesit e detyrës së drejtoreve të DPD-së, Thesari u ka njohur këtë drejtë, nga rrjedhe së edhe ankueses i takon shtesa në pagë si Menaxher II në vlerë prej 500 euro. Kërkon që Këshilli ta aprovoj ankesën dhe të obligoj Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit që të nxjerrë akt administrativ me të cilin ankueses ia njeh të drejtën e shtesës në pagë në vlerë prej 500 Euro nga dita e caktimit të shtesës si ushtruese e detyrës së Drejtorit të Drejtoratit për Prodhimin e Dokumenteve e deri në zbatimin e këtij vendimi duke përfshirë edhe kamatëvonesën prej 8%.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. *Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhënë edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofroje ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse



dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë. Andaj, meqenëse se Qeveria ende nuk ka miratuar nja vendim lidhur me shtesat për kategoritë e veçanta të profesioneve, gjegjësisht për kushte tregu, rrjedh se deri në një vendim të tillë, pretendimet ankimore të ankueses mbi bazën e kompensimit të pagës shtesë janë të pabazuara.

Ashtu si u tha me sipër, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.139/2022

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat [redacted]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.